REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITYOF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	**07.04.2023**
Referenca:	
Për :	**z. Imri Ahmeti -** Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	**z. Diamant Bytyqi -** Nënkryetar i Komunës **z. Lulzim Qerimi** – Nënkryetar për Komunitete
Nga:	**z.Valon Pacolli** - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	**Raport për muajin Mars - 2023**

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjthësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Nënshkrimi i memorandum bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me organizatën Help Kosova, për grante në zhvillim të ndërmarrësisë
- Nënshkrimi i kontratave me përfituesit e granteve për të riatdhesuarit nga projekti “Integra”
- Mbajtja e sesionit informues nga organizata Women for Women në kuadër të projektit “Mundësitë e Përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” për gratë
- Aktivitete dhe takime me organizatën UNDP për projektin e rivitalizimit të Janjevës,

- Takime me palë të interesuara për investime në Komunën e Lipjanit,
- Publikimi i draft-rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike për debat publik,
- Diskutime me nivelin qendror përkatësisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe KIESA për proceset të mbetura në vazhdim nga ana e tyre specifikisht për çështjen e vazhdimit të financimit të mëtutjeshëm të projektit të Zonës Ekonomike,
- Finalizimi i përzgjedhjes së përfituesve për shfrytëzim të pronave në kuadër të Zonës Ekonomike, faza e I-rë
- Përgatitje e faturave për shfrytëzuesit e pronës afatshkurtër komunale,
- Përgatitje e raporteve mujore për ngarkesat e shfrytëzuesve afatshkurtër të pronave komunale, raporte këto të adresuara Sektorit-Pronësoro Juridik.
-

STATISTIKAT

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT UDHËHEQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Pagesa të bizneseve për ndryshime	39	
2	Biznese të reja të regjistruara	24	
3	Duplikat dhe ndrrim të qertifikatave	8	
5	Kërkesë për ndryshim të adresës	2	
6	Shtim i njësisë së biznesit	4	
7	Vërtetim që nuk posedon biznes	4	
8	Shuarje të biznesit/njësive	0	
9	Shtim i aktivitetit të biznesit	0	
10	Informata të bizneseve	17	
11	Ndrrim i pronarit	4	
12	Kërkesë për ndryshim të emrit të biznesit	0	
13	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	2	
14	Ndrrim të tipit të biznesit	1	
15	Lëndë të refuzuara	0	